



PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIM IT BULETINI

of the IPA CBC Programmes
Montenegro-Albania and Montenegro-
Kosovo 2014-2020

Dhjetor 2023

FOTO: DITA E BASHKËPUNIMIT EVROPIAN – ZYRA E BASHKIMIT EVROPIAN NË KOSOVË

PËRMBAJTJA

Edicioni i tetëmbëdhjetë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi - Kosovë* 2014-2020. Programet dhe aktivitetet e projektit financohen nga Bashkimi Evropian.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA BNK Mali i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

»»» Dita e Bashkëpunimit Evropian është shënuar për herë të parë në Pejë...	2
»»» Të reja nga projektet në Thirrjen e II-të të Programit IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri.....	3
»»» Të reja nga projektet në Thirrjen e II-të të Programit IPA BNK Mali i Zi – Kosovë	5
»»» Të reja nga projektet në Thirrjen e III-ë të Programit IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri	5
»»» Të reja nga projektet në Thirrjen e III-ë të Programit IPA BNK Mali i Zi – Kosovë	7
»»» Takime dypalësh në Podgoricë.....	10
»»» Organizohen Takime Tematike në Zonën e Programit.....	10
»»» Takimi i parë i Komitetit të Përbashkët Monitorues në kuadër të IPA III Programit Mali i Zi - Kosovë është mbajtur në Podgoricë.....	11
»»» Lexoni për programin e ri të bashkëpunimit ndërkuftar IPA III Mali i Zi – Shqipëri.....	11
»»» Lexoni për programin e ri të bashkëpunimit ndërkuftar IPA III Mali i Zi – Kosovë.....	11

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi-Kosovë dhe nuk paraqet domosdoshmërisht mendimet e Bashkimit Evropian.

*Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKSKB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE - ALB
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020



MNE - KOS
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020

CBC ZOOM

Dita e Bashkëpunimit Evropian është shënuar për herë të parë në Pejë

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi dhe me mbështetjen teknike të Sekretariatit të Përbashkët Teknik më 13 tetor të vitit 2023 organizoi një sërë aktivitetesh me qëllim të shënimit të Ditës së Bashkëpunimit Evropian në kuadër të Programit IPA II të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë. Manifestimi u organizua për herë të parë në qytetin e Pejës në Kosovë dhe përfshinte një panair projektesh, një ekspozitë të përbashkët të të rinjve nga Peja dhe Gucia në kuadër të projektit të Trashëgimisë Kulturore dhe një vizitë në shtegun kulturor me biçikletë.

Ngjarja u moderua nga **Allmir Çausheviq** nga Sekretariati i Përbashkët Teknik i Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë i cili përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi përfituesit e projekteve për angazhimin e tyre në zbatimin e projekteve, duke deklaruar se rezultatet e arritura në kuadër të këtij Programi i dhanë mundësinë për të prezantuar bashkëpunimin ndërkufitar midis Malit të Zi dhe Kosovës si një shembull të bashkëpunimit të suksesshëm.



Zëvendësministri i MAPL-së, **Avdulah Gjesheviq**, në emër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se bashkëpunimi evropian përfshin krijimin dhe zbatimin e politikave, standardeve dhe aktiviteteve që synojnë arritjen e kohezionit social dhe përmirësimin e mirëqenies së njerëzve që jetojnë në këtë rajon.



Ai shtoi se marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal janë parakushte thelbësore për anëtarësim, ndërsa forcimi i bashkëpunimit ndërrajonal dhe ndërkufitar përbën premisën parësore për zhvillimin social dhe ekonomik.

Ai e vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi si një bashkëpunim të sinqertë dhe konkret ndërmjet vendeve fqinje që ndikon pozitivisht në aspektet endryshme të jetës së qytetarëve, promovon marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve, hap perspektiva zhvillimore, përmirëson menaxhimin ndërkufitar mjedisor dhe ofron shkëmbim të praktikave dhe përvojave më të mira.

Më pas, shefi i Bashkëpunimit Ekonomik në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, **Johannes Madsen Stenbaek**, tha se është kënaqësi të marr pjesë në Ditën e Bashkëpunimit Evropian për të festuar të arriturat e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, duke theksuar se bashkëpunimi përtej kufijve është një ide themelore e një Evrope të bashkuar dhe shërben si një mjet i fuqishëm për të ndërtuar prosperitet në të gjithë kontinentin.

"Një herë në vit, në Ditën e Bashkëpunimit Evropian, ne shfrytëzojmë rastin për të diskutuar arritjet tona të rëndësishme dhe për të festuar suksesin e shumë programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, transnacional dhe ndërrajonal të financuara nga BE," tha ai. Ai shtoi se programet ndërkufitare dhe njerëzit që i zbatojnë ato, punojnë pa u lodhur drejt këtij qëllimi dhe kryesisht njihen si programe që sjellin një cilësi më të mirë të jetës për popullatën vendase.



Ai theksoi se karakteristikat kryesore të projekteve të bashkëpunimit janë se ato bashkojnë njerëz nga horizontet shumë të ndryshme, ndihmojnë në ndërtimin e besimit, promovojnë mirëkuptimin e ndërsjellë dhe se këto janë gurë themeli për çdo partneritet afatgjatë. Ai nënvizoi se është i kënaqur që dy vendet, Kosova dhe Mali i Zi, po finalizojnë bashkërisht një proces të suksesshëm të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II dhe se suksesi është i mundur vetëm përmes partneriteteve të forta dhe bashkëpunimit ndërmjet partnerëve të ndryshëm nga organizatat shoqërore civile, autoritetet lokale, kombëtare dhe komunat, dhe se BE-ja vazhdon të mbështesë zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe zhvillimin ekonomik të rajoneve kufitare.



Pas fjalimeve, të pranishmit patën mundësinë të vizitojnë panairin me stenda të mbushura me materiale promocionale dhe informative të projekteve, të vizitojnë ekspozitën (koloninë e artit) me vepra artistike të krijuara në kuadër të projektit "Trashëgimia Kulturore - Thesar Rajonal", mullirin Haxhi Zeka, të bëjnë një xhiro me biçikletë në qytetin e Pejës në kuadër të projektit të rrugës kulturore si dhe të shijonë ushqimet tradicionale.

Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Përfundon Projekti mbi Përdorimin e Bimëve Mjeksore dhe Aromatike

Më 28 dhjetor të vitit 2023, konferenca ndërkufitare shënoi përfundimin e *Projektit Promovimi i Përdorimit të Qëndrueshëm të Bimëve Mjeksore dhe Aromatike për Përmirësimin e Jetesës dhe Mbrojtjen e Biodiversitetit*. Konferenca u organizua nga Qendra për Integrim Demokratik dhe Zhvillim dhe Komuna e Plavës në bashkëpunim me Bashkinë e Tropojës dhe OJF Alpet Shqiptare.

Tematika e konferencës u përqendrua në "Mbështetjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm Mjedisor në Shqipëri dhe Mal të Zi". Në konferencë, ku morën pjesë 58 pjesëmarrës, u theksua rritja e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit për të menaxhuar asetet mjedisore dhe veçanërisht bimët mjeksore dhe aromatike (BAM). Liderët e projektit prezantuan rezultatet e arritura, të dhënat dhe planet për aksione të ardhshme që do të rrisin angazhimin e vazhdueshëm ndërkufitar për iniciativë të zhvillimit mjedisor në rajon.

Fatkeqësitë Nuk Njohin Kufinj 2 shënon fundin e aktiviteteve

Konferenca përmbyllëse e *Projektit Fatkeqësitë Nuk Njohin Kufinj 2* u mbajt në Budva në datat 13 dhe 14 dhjetor, gjatë së cilës u prezantuan

rezultatet kryesore të këtij projekti, si dhe rekomandimet për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit.



Me këtë rast, **Veselin Shturanoviq**, drejtor ekzekutiv i FORS Montenegro, **Ervis Krymbi** profesor në Universitetin e Shkodrës dhe **Milosav-Miki Koraq** komandant i Shërbimeve të Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Beranes dhanë deklarata për mediat. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të institucioneve dhe organizatave që kanë marrë pjesë në zbatimin e projektit, si dhe gjatë punës dy-ditore u theksua rëndësia e projektit, mësimet e nxjerra, sfidat dhe rekomandimet për projekte dhe iniciativë të ardhshme në rajon.



Aktivitetet kryesore të këtij projekt kanë përfshirë prokurimin e paisjeve për mbrojtjen ndaj përmytjeve dhe zjarreve për shërbimet e mbrojtjes dhe shpëtimit, prokurim për paisjet e parashikimit të kushteve hidrometeorologjike, trajnime ndërkufitare, ushtrime në terren dhe punëtori për punonjësit e shërbimeve dhe institucioneve që merren me mbrojtjen dhe shpëtimin, një konferencë për forcimin e sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit, trajnime që lidhen me sistemin e parashikimit dhe lajmërimit të hershëm, një fushatë për informimin e popullatës rreth rreziqeve të përmytjeve, zjarreve dhe uljes së riskut për fatkeqësitë natyrore, punëtori për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, ushtrime evakuimi etj.

Në Podgoricë u mbajt konferenca përmbyllëse e projektit SOLUTION

Projekti Liqeni i Shkodrës PA NDOTJE Kimike-SOLUTION, zbatuar nga Qendra për Hulumtime Ekotoksikologjike në Mal të Zi, organizoi konferencën përmbyllëse në Podgoricë me datë 28 shtator të vitit 2023.

Gjatë këtij eventi, u prezantuan rezultatet e projektit për të pranishmit dhe për mediat. U konkludua se mjedisi tejkalon kornizat politike dhe ligjore si dhe kufinj të krijuar nga njeriu.

Gjithashtu u konkludua se një program kërkimor për të monitoruar përqendrimin e insekticidit specifik në lumin Moraça dhe ujërat nëntokësorëpërgjatë një cikli gjashtëvjeçar që nënkupton analizen e 12 mostrave për çdo vit.



Poashtu, u theksua se Shqipëri dhe Mal të Zi duhen të zhvillojnë strategji në lidhur me kontrllimin e HAP emetimeve në përputhje me ligjet e BE-së si dhe domosdoshmëria për programe monitoruese thelbësore për lokalizimin e pesticideve të ndaluara dhe vlerësimin e niveleve të metaleve që derdhen në Liqenin e Shkodrës. Monitorimi i vazhdueshëm i peshkut të Liqenit të Shkodrës është thelbësor në sigurimin e përputshmërisë me rregullat e sigurisë ushqimore lidhur me nivelet e ndotjes.

Përfundon projekti A.C.C.E.N.T

Si pjesë e *projektit A.C.C.E.N.T*, u zhvillua në Shkodër në ambjentet e Hotel Colosseo në datën 8 shtator të vitit 2023 Panairi i Punësimit për personat me aftësi të kufizuara. Panairi i Punësimit solli së bashku organizata nga sektorë të ndryshëm, të cilat shërbyen si mundësi diskutimi për punësimin e PAK. Për më shumë detaje shikoni [këtu](#) raportimin e mediave lokale lidhur me Panairin e Punësiit të mbajtur në Shkodër.



Pas këtij aktiviteti, partnerët e projektit organizuan konferencën përmblylëse në Tivar, e cila u ndoq nga 60 pjesëmarrës nga institucionet, organizatat dhe kompanitë private që merren me punësimin dhe çështjet e rëndësishme lidhur me përmirësimin e kushteve të personave me aftësi të kufizuara. Një ndër rezultatet më të rëndësishme të projektit është fakti se 23 persona me aftësi të kufizuara patën mundësinë të zhvillonin praktika profesionale përgjatë një viti tek punëdhënës të ndryshëm. Një numër i qenësishëm prej 45% e PAK vazhduan të jenë të punësuar edhe pas përmblyljes së projektit. Për sa i përket vetëpunësimit janë mbështetur katër iniciativatë personave me aftësi të



kufizuarabazuar në idetë e tyre të biznesit, mbi 120 persona me kanë vijuar trajnimet, janë hartuar 5 kurrikula për trajnime jo-formale si dhe u zhvilluan shtatë programe edukimi të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.



Margegaj Zero Mbetje si një shembull i mirë

Si pjesë të aktiviteteve të *projektit Mali i Zi dhe Shqipëria drejt Zero Mbetjeve*, zbatuar nga Agjencia Rajonale për Zhvillimin e Bjellasicës, Komovi dhe Bjeshkëve të Namuna, Zero Mbetje Mali i Zi dhe Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale, Njësia Administrative Margegaj e Bashkisë Tropojë ka patur përfitime të shumta. Janë ndërmarrë një sërë aksionesh komunitare dhe fushata ndërgjegjësimi ndërkohë që janë ngritur edhe objekte për mbledhjen e materialit dhe kompostimin komunal me fokus mbetjet dhe transportimin manual. Për më shumë shikoni [këtu](#) mbulimin mediatic.



Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Pajisjet për institucionet shëndetësore



Në kuadër të projektit CARES 2, partnerët e projektit FORS nga Mali i Zi dhe ECMI Kosova, vazhduan me aktivitetet në të dy anët e kufirit. Pajisjet për ekzaminime parandaluese për shëndetin riprodhues janë dorëzuar në institucionet shëndetësore në Gjakovë, Pejë, Istog, Klinikë dhe Deçan, ndërsa stafi mjekësor është trajnuar për përdorimin e kësaj pajisjeje.

Projekti mundësoi organizimin e 2923 ekzaminimeve parandaluese për grupet vulnerabël të grave në zonën ndërkuftare.



Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

S'ka kufinj për punë!

Me qëllim përmirësimin e zhvillimit ekonomik gjithëpërfshirës në zonat kufitare të Fushë Arrëzit, Malësisë së Madhe dhe zonat e Cetinës dhe Podgoricës po zbatohet Projekti Pa kufi për punë! Ky projekt dy-vjeçar po zbatohet nga një konsorcium partnerësh të udhëhequr nga Kryeqyteti i Vjetër Mbretëror i Cetinës, ProAct Hub, Instituti për Politika të Qëndrueshme dhe Bashkia Fushë Arrëz.

Si pjesë e aktiviteteve të parashikuara është ngritur në Cetinë një stacion podcasti. Kjo strukturë është ngritur me qëllimin për të informuar,



frymëzuar dhe mbështetur të rinjtë e ardhshëm sipërmarrës në Cetinë dhe më gjërë.

Ky projekt ka për qëllim të përmirësojë punësueshmërinë dhe përfshirjen sociale të të rinjve, grave, punëkërkesve të papunë afatgjatë dhe PAK në sektorët e turizmit rural dhe shërbimeve të kateringut, iniciativat e ekonomisë së gjelbër/rrethore, bujqësi dhe në sipërmarrjen sociale.



Mjet i ri për mbledhjen e mbetjeve në kuadër të projektit Aksioni i Përbashkët për Mbrojtjen e Mjedisit-JEPA

Komuna e Gucisë dhe Bashkia Pukë po zbatojnë sëbashku projektin Aksioni i Përbashkët për Mbrojtjen e Mjedisit-JEPA. Si pjesë e aktiviteteve në 14 dhjetor të vitit 2023 komuna e Gucisë prokuroi një mjet për mbledhjen e mbetjeve, i cili u dorëzua tek kompania e shërbimeve e Gucisë.



Ky projekt do të përmirësojë sistemin e menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit, nëpërmjet përmirësimit teknik të kapaciteteve të personelit të njësive lokale për menaxhimin e mbetjeve, si dhe nëpërmjet rritjes së njohurive dhe aftësive të studentëve mbi mbrojtjen e integruar të mjedisit, ekonominë e rrethore dhe menaxhimin e mbetjeve.

Mbahet Puntoria për bizneset mbi temën e mentorimit

Me 28 shtator të vitit 2023 u mbajt një punëtori në ambientet e Agjencisë Shqiptare për Investim dhe Zhvillim (AIDA) për bizneset pjesëmarrëse në projektin *Aftësi për Punësimin e Qëndrueshëm dhe Rritjen Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndër-Kufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi-Aftësi për Punë*.



Aktiviteti solli sëbashku përfaqësues të bizneseve që ishin shpallur fituese në thirrjen e hapur publike gjatë fazës së aplikimit. Pjesëmarrësit në puntori u njohën me Guidën për Mentor, e cila është hartuar për të ndihmuar të gjithë mentorët gjatë zbatimit të trajnimit në vendin e punës.



Gjithashtu, bizneset pjesëmarrëse u prezantuan me paketën e plotë të dokumentave të nevojshëm për tu plotësuar gjatë periudhës së trajnimit. Gjatë puntorisë së udhëhequr nga eksperti, pjesëmarrësit u angazhuan edhe në ushtrime praktike me ide dhe sugjerime për përfundimin e programit të trajnimit në varësi të sektorit të interesit.

Ndërtojmë Pyje të Zgjuara

Partnerët e projektit *Ndërtojmë Pyje të Zgjuara* po vazhdojnë me aktivitetet e projektit lidhur me ngritjen e ndërgjegjes dhe përgatitjen e procedurave për blerjen e paisjeve të vyer që do të bëjnë të mundur identifikimin e hershëm të zjarreve në zonën ndërkufitare.



Gjithashtu, me qëllim konsultimin e grupeve të interesit të përfshira në këtë proces, u organizua një mbledhje ndërmjet partnerëve të projektit dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve për të diskutuar aspektet e projektit, procesin e instalimit të sistemit teknologjik për detektimin e zjarreve në fazë të hershme dhe përdorimin e dronëve për mbikqyrje.



Projekti *Ndërtojmë Pyje të Zgjuara* po zbatohet nga Fondacioni për Autonomi Lokale dhe Qeverisje (FLAG) në Shqipëri, në partneritet me Komunene Tivarit dhe Bashkinë e Shkodrës.

Ujëmbledhësi i Liqenit të Shkodrës- një Rezervuar i Biosferës Ndërkufitare

Projekti *Ujëmbledhës i Liqenit të Shkodrës- një Rezervuar i Biosferës Ndërkufitare* po zbatohet nga Qendra EDEN për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim, Programi Mjedisor -EnvPro, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë si dhe Ndërmarrja Publike e Parqeve Kombëtare

të Malit të Zi. Skuadra zbatuese e projektit filloi me aktivitetet e projektit me një punëtori të quajtur "Cili mund të jetë kufiri dhe vizioni për Ujëmbledhësin e Liqenit të Shkodrës- një Rezervuar i Biosferës Ndërkufitare i UNESCO-s" e cila u mbajt në Shkodër me 22 dhjetor të vitit 2023.



Kjo punëtori solli së bashku 38 palë të ndryshme të interesuara, që përdorën këtë mundësi për të ndarë ide, diskutuar dhe dakorduar mbi hapat e mëtejshme që duhen ndërmarrë në mënyrë që Liqeni i Shkodrës të bëhet një Rezervuar Biosfere i UNESCO-s.



Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Aktivite për ngritjen e kapaciteteve për kompanitë komunale nga Tuzi dhe Peja

Komuna e Tuzit, në partneritet me komunën e Pejës, është duke zbatuar projektin *Qasja e Re në Revitalizimin e Mjedisit – NERA* që do të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit përmes një qasjeje të orientuar strategjikisht në komunitetet lokale në Mal të Zi dhe Kosovë.



Trajnimi dyditor që titullohej "Menaxhimi i Mbeturave Komunale", u organizua për përfaqësuesit e kompanive për shërbime komunale të Komunës së Tuzit dhe Komunës së Pejës, "Komunale" Sh.p.k., NPL "EKO-SIG" sh.a dhe "Ambienti" sh.a. kompania rajonale për grumbullimin e mbeturinave.



Në trajnim, ekspertët për programin e qyteteve me zero mbetje, **Vanja Cicmil** dhe **Marina Tomoviç** folën mbi metodat e inkorporimit të një sistemi të qëndrueshëm të grumbullimit të ndarë të mbetjeve në nivel komunal, menaxhimin e mbetjeve organike, strategjinë kalimtare për menaxhimin e mbetjeve, si dhe mbi metodat për parandalimin e mbetjeve në institucione përmes gjelbërimit. Gjithashtu u prezantuan shembuj të praktikës së mirë në aplikimin e metodologjisë për komunat me zero mbetje/mbeturina, e cila zbatohet në mbi 480 qytete në mbarë Evropën dhe rezultatet e tyre, si dhe mundësitë e aplikimit në kontekstin lokal të komunave si Tuzi dhe Peja.

Ndiqui [faqen e projektit](#) për më shumë informacion.

Të rinjtë NEET: mundësi të reja për punë dhe rritje të punësimit - "UNEETED"

Me qëllim të përmirësimit të pozitës sociale të të rinjve që nuk janë në arsim, punësim apo trajnim (NEET) në komunat e përzgjedhura në Mal të Zi dhe Kosovë duke rritur punësueshmërinë e tyre dhe duke i lidhur me punëdhënësit potencial, Instituti për Studime dhe Projeksione Strategjike (ISSP), Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), Oda Ekonomike e Malit të Zi dhe Komuna e Mojkovcit po zbatojnë projektin **Të rinjtë NEET: mundësi të reja për punë dhe rritje të punësimit – "UNEETED"**. Si pjesë e aktiviteteve të projektit, partnerët shpallën një thirrje publike për personat e papunë për një trajnim tre mujor për zhvillimin e ideve të biznesit.

Aftësitë për Punësim të Qëndrueshëm në Rajonin Ndërkufitar të Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës - Pa Kufi!

Projekti *Aftësitë për Punësim të Qëndrueshëm në Rajonin Ndërkufitar të Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës – Pa Kufi!* synon të kontribuojë në rritjen e aftësive dhe kompetencës profesionale të të rinjve dhe grave të papuna në rajonin ndërkufitar me qëllim plotësimin e nevojave për punësim në sektorin e turizmit dhe hotelerisë. Projekti është duke u implementuar nga Oda Ekonomike e Malit të Zi, Oda Ekonomike e Republikës së Kosovës, Qendra Rajonale e Biznesit Berane dhe Instituti për Arsim, Trajnim dhe Hulumtim - ETRI.

Projekti shpalli thirrjet për aplikim dhe përzgjedhje të kandidatëve për trajnim për rritjen e aftësive të punësimin në sektorët e turizmit (guida turistike) dhe mikpritjen (kuzhinierë, bukëpjekës, kamerierë). Pas fillimit të trajnimit janë përzgjedhur kandidatët për trajnime teorike dhe kandidatët të cilët do të ndjekin trajnimin në vendin e punës në periudhën e ardhshme.

Rilindja Kulturore nga Liqeni i Shkodrës në Kosovë - TIME TRAVEL

Projekti *Rilindja Kulturore nga Liqeni i Shkodrës në Kosovë – TIME TRAVEL* filloi me aktivitetet e tij ndërgjegjësuese. Konkreisht, konferenca fillestare e projektit u mbajt në Podgoricë më 27 shtator të vitit 2023.



Gjatë konferencës u njoftua se zbatimi i aktiviteteve të planifikuara do të çojë në ngritjen e një produkti të ri turistik ndërkufitar bazuar në trashëgiminë historike dhe kulturore të rajonit, si dhe në produkte dhe shërbime cilësore vendase. Projekti pritet të kontribuojë në një prezantim interesant dhe integral të atraksioneve kulturore-historike dhe produkteve tradicionale nga zonat e Kosovës dhe Malit të Zi, si dhe në lidhjen e suksesshme të ofruesve të shërbimeve me vizitorët në këtë rajon.



Evokimi dhe tërheqja e trashëgimisë kulturore - Antikiteti i Krishterë dhe Banja Turke për Turizmin Kulturor

Projekti *Evokimi dhe tërheqja e trashëgimisë kulturore – Antikiteti i Krishterë dhe Banja Turke për Turizmin Kulturor* do të kontribuojë në rritjen e konkurrencës ekonomike të zonës duke rritur potencialin turistik-kulturor të zonës. Ky projekt është duke u realizuar nga IP Muzeu i Polimjes nga Berana dhe Marimangat e Pejës - Shoqata e Alpinistve nga ana e Kosovës. Deri më tani janë kryer disa aktivitete në lidhje me konservimin e planifikuar (është projektuar një projekt konservues për Banjen Turke në Pejë), janë zhvilluar dy modele dixhitale të *Tumbarice castrum* (Beranë) dhe *Banja Turke* (Pejë) para kryerjes së punimeve konservuese dhe janë inicuar gërmimet arkeologjike në *Tumbarice castrum* (Beranë), si dhe janë prokuruar pajisjet e parashikuara.



C.L.O.S.E.R. - Rigjallërim i qëndrueshëm ekonomik përmes mundësive të bazuara në kulturë

Fondacioni i Kosovës për Trashëgimi Kulturore pa Kufij, në partneritet me Komunën e Tivarit po zbaton një projekt dyvjeçar "C.L.O.S.E.R. – Rigjallërim i qëndrueshëm ekonomik përmes mundësive të bazuara në kulturë".



Si pjesë e projektit, në Pejë u mbajt punëtorja e parë ndërkufitare për *Zhvillimin e Planit të Menaxhimit të Qendrës Kreative Përendimore*. Punëtorja u organizua për të nxitur shkëmbimin e njohurive ndërmjet partnerëve, ku *Qendra Kreative nga Tivari* (Mali i Zi), ndau përvojat e tyre të fundit për të ndihmuar në formimin Qendrës Kreative Përendimore.

Rezultatet më domethënëse të pritshme të projektit janë përshtatja dhe vënia në përdorim e objektit të trashëgimisë kulturore në Kosovë që do të përdoret si qendër kreative e Rajonit Ekonomik Perëndimor, si dhe rivitalizimi i rrugëve të vjetra të qytetit të vjetër të Tivarit duke përfshirë edhe punime pastrimi, sinjalizimi dhe punime të vogla të konservimit.

Shëndrimi i fshatrave tona në destinacione turistike

Agjencia për Zhvillim Rajonal- Perëndim, në bashkëpunim me Komunën e Pejës dhe me mbështetjen e Agjencisë për Zhvillim Rajonal për Bjelasicë, Komovi dhe Bjeshkët e Nemunanë Mal të Zi, organizuan dy udhëtime studimore në Mal të Zi si pjesë e projektit *Shëndrimi i fshatrave tona në destinacione turistike*. Udhëtimet u zhvilluan në periudhën 19-20 tetor dhe 24-25 tetor të vitit 2023, duke përfshirë vizita në pesë lokacione të turizmit rural në Mal të Zi. Pjesëmarrësit, duke përfshirë familjet rurale nga Peja të angazhuara në bujqësi dhe prodhim ushqimor, si dhe organizatat lokale dhe operatorët turistikë, fituan njohuri dhe përvoja për integrimin e shërbimeve turistike në bizneset e tyre.



Këto udhëtime janë pjesë e përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve krahas seminareve dhe sesioneve të ardhshme trajnimi të fokusuara në zhvillimin e turizmit rural.



Në Punësim, Arsim, Trajnim - IN EET

Për të inkurajuar përfshirjen sociale të grupeve të cenueshme të popullsisë, si dhe aksesin e tyre në tregun e punës, OJQ Juventas nga Mali i Zi dhe OJQ Labyrinth nga Kosova po zbatojnë projektin *Në Punësim, Arsim, Trajnim - IN EET*.

Si pjesë e aktiviteteve, partnerët e projektit shpallën thirrjen për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u regjistruar për një trajnim profesional tre mujor në Podgoricë. Kandidatët e përzgjedhur do të punojnë në 8

organizata joqeveritare. Pritet që 40 të rinj do të marrin pjesë dhe do të bashkëpunojnë me punëdhënës të ndryshëm.



Turizmi për të Ardhmen

Projekti dyvjeçar *Turizmi për të Ardhmen* zbatohet nga OJQ Prishtina REA në partneritet me Shoqatën Alpiniste "Gjeravica" nga Kosova dhe partnerët malazezë, Komunën e Kollashinit dhe Institutin për Ndërmarrësi dhe Zhvillim Ekonomik. Një sërë aktiviteteve u zbatuan në tremujorin e fundit të vitit 2023. Më konkretisht, në Kolasin u mbajt trajnimi "*Sistemi i Menaxhimit Efektiv të Qëndrueshëm dhe Eko-Zhvillimit*" i cili u fokusua në aspektet kyçe të turizmit të qëndrueshëm.



Gjithashtu, dy sesione informative për Thirrjet për Grante – "Certifikimi me Standardet Ndërkombëtare ECO LABEL" janë mbajtur në Pejë me datë 21 dhjetor 2023 dhe në Kolasin më 22 dhjetor të vitit 2023.



Qëllimi i projektit është të kontribuojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm ndërkufitar përmes rrjetëzimit, futjes së çelësit të gjelbër

dhe standardeve eko, përmirësimi të konkurrencës dhe promovimit të përbashkët. Shikoni videon promovuese të projektit [këtu](#).

Takime dypalësh në Podgoricë

Më 8 shtator të vitit 2023, në Podgoricë u organizua një takim dypalësh ndërmjet strukturave të Programit IPA BNK Mali i Zi – Kosovë. Takimi u organizua për të diskutuar mbi Programim e ardhshëm IPA III dhe aktivitetet aktuale të Programit. Poashtu, në Podgoricë është mbajtur edhe një takim bilateral me date 19 dhjetor të vitit 2023, gjatë të cilit është diskutuar mbi aspektet e ndryshme lidhur me hapat e nevojshme për shpalljen e Thirrjes së pare në kuadër të IPA III Programit, si edhe mbi organizimit e evenimenteve përmblyëse në kuadër të IPA II Programit.



Organizohen Takime Tematike në Zonën e Programit

Gjatë muajve tetor dhe nëntor janë mbajtur takime tematike me përfaqësues të komunave nga zona e IPA programeve të bashkëpunimit ndërkufitarë Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë. Takimet u organizuan me qëllim promovimin e rezultateve të projekteve të financuara në kuadër të këtyre dy programeve dhe promovimin e programeve të reja të ardhshme IPA III BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2021-2027. Takimet ishin një mundësi për përfaqësuesit e komunave/bashkive dhe autoriteteve/kompanive të tjera lokale për të marrë informacion më të detajuar për të dy IPA III programet dhe për të bërë pyetje në lidhje me programin, strukturat e programit, qëllimet dhe prioritetet tematike dhe thirrjet e ardhshme për dërgimin e projekt propozimeve.



Takimet tematike janë mbajtur në 31 komuna /bashki, nga të cilat me 16 komuna në Mal të Zi, nëntë në Shqipëri dhe gjashtë në Kosovë. Takimet janë zbatuar nga Sekretariati i Përbashkët Teknik (SPT) dhe, në varësi të vendit ku është mbajtur takimi, nga përfaqësues të Ministrisë së Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndhmës së Republikës së

Shqipërisë dhe Ministrisë së administrimit të pushtetit lokal të Republikës së Kosovës. Takimet ngjallën interes të madh dhe morën pjesë 139 pjesëmarrës. Të gjitha komunat e vizituara shprehën gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në programet e ardhshme IPA III në të gjitha prioritetet tematike që janë të parapara brenda programeve.



nteresi kryesor i pjesëmarrësve ishte i fokusuar në mundësitë për investime në kuadër të projekteve në kuadër të programeve, kornizën financiare, zarin financiar dhe çështjet e bashkëfinancimit dhe parafinancimit të programeve dhe granteve, si dhe aspektet e zbatimit. Përveç kësaj, janë dhënë sqarime lidhur me përshtatshmërinë e aktiviteteve dhe partneritetit, thirrjeve për dërgimin e projekt propozimeve dhe rregullave të tjera që janë të zakonshme brenda procesit të aplikimit dhe zbatimit.



jë ndër pikat kryesore të diskutimit gjatë këtyre takimeve u fokusua mbi kapacitetet e bashkive, institucioneve e ndërmarrjeve lokale publike lidhur me shkrimin dhe zbatimin e projekteve të financuara nga BE. Përfundimi që aplikohet pothuajse për të gjitha bashkitë është ekzistenca e nevojës për më shumë ngritje kapacitetesh shtesë tek Bashkitë dhe institucionet respektive, gjë e cila do të ofrohet gjatë periudhës së ardhshme falë aktiviteteve kapacitet-ngritëse që do të financohen nga programi përgjatë vitit 2024. ata do të ftohen të marrin pjesë.



Në kuadër të IPA III Programit të bashkëpunimit ndërkufitarë Mali i Zi – Shqipëri janë vënë në dispozicion 10.7 milionë euro për projektet në kuadër të Fushës Tematike 2: Efiçencë e përmirësuar dhe më e gjelbër burimesh dhe Fushës Tematike 4: Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe konkurrueshmërisë. Ndërsa në kuadër të IPA III Programit të bashkëpunimit ndërkufitarë Mali i Zi – Kosovë 2021-2027 në dispozicion janë 7.5 milionë euro për projekte nga Fusha Tematike 1: Përmirësimi i mundësive të punësimit dhe i të drejtave sociale dhe Fushës Tematike 4: Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe konkurrueshmërisë.



Takimi i parë i Komitetit të Përbashkët Monitorues në kuadër të IPA III Programit Mali i Zi - Kosovë është mbajtur në Podgoricë

Strukturat e IPA BNK të programit Mali i Zi – Kosovë organizuan në Podgoricë më 19 dhjetor të vitit 2023 takimin e parë të Komitetit të Përbashkët Monitorues (KPM) në kuadër të IPA III BNK Programit Mali i Zi-Kosovë 2021 – 2027. Takimi u organizua me qëllim të miratimit të Rregullores së Procedurës së KPM-së, si dhe propozimin për ndarjen financiare, prioritetet tematike, objektivat, aktivitetet dhe subjektet e pranueshme për Thirrjen e parë për dërgimin e projekt propozimeve që pritet të publikohet gjatë gjysmës së parë të vitit 2024.



Lexoni për programin e ri të bashkëpunimit ndërkufitar IPA III Mali i Zi - Shqipëri

Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Republika e Shqipërisë për 2021-2027 do të zbatohet përmes dy grupeve tematike duke përfshirë një prioritet tematik (TP) për secilin prej këtyre grupeve. Dokumenti i Programit parasheh grupin tematik Efiçenca më e përmirësuar dhe e gjelbër e burimeve të sipas të cilit prioriteti tematik **Mbrojtja e mjedisit, përshtatja dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut** si TP1 për këtë Program dhe grupi tematik Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe konkurrueshmërisë sipas të cilit Prioriteti tematik **Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore** është përzgjedhur si TP 2 për këtë Program.

Zona e programit në Mal të Zi do të jetë: Andrijevica, Tivar, Berane, Budva, Cetinje, Danilovgrad, Guci, Kolashin, Petnjicë, Plavë, Podgoricë, Rozhaje, Tuz, Ulqin dhe Zetë dhe në Shqipëri: Qarku i Shkodrës, Qarku Lezhë dhe Rrethi Tropojë.

Buxheti i përgjithshëm i programit është 13,790,000 euro, ndërsa kontributi i BE-së është **11,900,000 euro**. Dokumenti i programit për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Republika e Shqipërisë për 2021-2027 mund të shkarkohet [këtu](#).

Cross-Border
Cooperation



Funded by
the European Union

Montenegro – Albania

Lexoni për programin e ri të bashkëpunimit ndërkufitar IPA III Mali i Zi - Kosovë

Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë për 2021-2027 do të zbatohet përmes dy grupimeve tematike duke përfshirë një prioritet tematik (TP) për secilin prej këtyre grupeve. Dokumenti i Programit parasheh grupin tematik Përmirësimi i mundësive të punësimit dhe të drejtave sociale sipas të cilit prioriteti tematik **Punësimi, lëvizshmëria krahut/ofertës së punës dhe përfshirja sociale dhe kulturore përtej kufijve** është zgjedhur si TP1 për këtë Program dhe grupi tematik Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe konkurrueshmërisë sipas të cilit prioriteti tematik **Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore** është përzgjedhur si TP 2 për këtë Program.

Zona e programit në Mal të Zi do të jetë: Andrijevica, Tivar, Berane, Bijelo Pole, Guci, Kolashin, Mojkovac, Petnjicë, Plavë, Podgoricë, Rozhaje, Tuz, Ulqin dhe Zetë, ndërsa në Kosovë: Pejë, Istog, Kline, Junik, Deçan dhe Gjakovë.


Buxheti i përgjithshëm i programit është 9.734.118 euro, ndërsa kontributi i BE-së është **8.400.000 euro**. Dokumenti i programit për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë për 2021-2027 mund të shkarkohet [këtu](#).

Cross-Border
Cooperation



Funded by
the European Union

Montenegro – Kosovo



»» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



Ministry
of European Affairs



Montenegro
Ministry of Finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministristvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – Zyra kryesore

Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik

E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat

E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti

E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti

E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ

E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – Zyra Antenë Shkodër

Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Nersada MANDIJA

Zyrtare Projekti, Antenë

E-mail: nersada.mandija@saspac.gov.al

Sekretariati i Përbashkët Teknik – Zyra Antenë Prishtinë

Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53, Prishtinë,
Kosovë

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë

E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



@cbc.mne.alb



@cbc.mne.kos



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian